

## **RREGULLORE PËR PROCEDURAT E HEQJES SË LICENSAVE NË SEKTORIN E ENERGIJË ELEKTRIKE DHE TË GAZIT NATYROR.**

### **Neni 1 Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 42, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 27 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”

### **Neni 2 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent, për të gjithë të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, për të cilët merret vendimi për të hequr një licensë, përmes vendosjes së procedurave të njëjta për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në rastet e heqjes së një license.

### **Neni 3 Objekti**

Kjo rregullore përcakton procedurat që aplikohen për heqjen e një license të dhënë sipas Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, në përputhje me Rregullorja e Organizimit dhe funksionimit të ERE’ dhe Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike miratuar me Vendim të Bordit të ERE-s 96 datë 17.06.2016; Rregullat dhe Procedurat për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesëshëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror. (Miratuar me Vendimin Nr. 9 datë 11/02/2011).

### **Neni 4 Përkufizime**

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë Rregullore kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. **“Ligj”** do të thotë Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe ligji 102/2015 ‘Për sektorin e gazit natyror’
2. **“Bordi ”** do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe Ligjin nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
3. **“Enti Rregullator i Energjisë”** ose **“ERE”** është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin “Për sektorin e gazit natyror”.
4. **“Licensë”** është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike ose të gazit natyror
5. **“I licensuar”** do të thotë një person që mban një licensë të dhënë në kuptim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
6. **“Procedurë”** do të thotë një tërësi veprimesh, që kryhen në zbatim të legjislacionit në fuqi.

## **PJESA E DYTË PROCEDURAT E HEQJES SË NJË LICENSE**

### **Neni 5 Rastet e Heqjes së një License**

ERE heq një licencë kur i licencuari:

- a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë sipas këtij ligji;
- b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;
- ç) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet ligji
- d) bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;
- dh) me kërkesë të të licencuarit;
- e) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

### **Neni 6 Fillimi i procedurave**

Në të gjitha rastet që personat e ngarkuar nga ERE konstatojnë një pao disa nga shkeljet e parashikuara në nenin 5 të kësaj rregullore, Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim përgatit një informacion për Bordin e ERE-s, mbi shkeljet e konstatuara si dhe i propozojnë Bordit marrjen e një vendimi për të filluar procedurën për heqje license.

## **Neni 7**

### **Njoftimi dhe përmbajtja e tij**

Me nisjen e procedurës për heqjen e një liçence, ERE :

- a) njofton me shkrim të licencuarin për fillimin e procedurave për heqjen e licencës duke shprehur qartësisht arsyet për heqjen e licencës;
- b) respekton të drejtën e të licencuarin për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës;
- c) kur është në interesin publik, mund t'i japë të licencuarit 30 ditë kohë, pas përgjigjes së tij me shkrim, që të veprojë në përpunje me kushtet e licencës dhe të shmangë shkakun për heqjen e saj.

## **Neni 8**

### **Propozimi përfundimtar**

Pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari brenda afatit të përcaktuar më sipër, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 60 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentat e paraqitur dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t'i propozojnë Bordit për mbylljen ose jo të procedurës së nisur për heqje license ose për ti dhënë mundësi të licencuarit ndaj të cilit ka filluar procedura për heqje license, që të mënjanojë brenda 30 ditëve shkaqet për të cilat është propozuar heqja e licenses.

## **Neni 9**

### **Vendimi i Bordit**

Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje, dhe pasi është njohur me përgjigjen e të licencuarit, Bordi do të vendosë për shtyrjen afatit të mbylljes së procedurave ose heqjen e liçencës.

Në rast të marrjes së Vendimit për heqje license, nga Bordi i , ERE njofton Këshillin e Ministrave, në përpunje me nenin 42, pika 8 i Ligjit 43/2015 'Për sektorin e energjisë

elektrike, ose nenit 27 të Ligjit 102/2015 'Për sektorin e gazit natyror' për procedurat e nisura ndaj një të licensuari në sektorin e gazit natyror.

## **Neni 10** **Njoftimi për Vendimin**

Në përfundim të një procedure për heqje license, ERE do të njoftojë të licensuarin mbi përfundimin e procedurës së nisur ndaj tij si dhe do t'i dërgojë një kopje të Vendimit të Bordit të ERE.

## **Neni 11** **Shqyrtimi gjyqësor**

Kundër Vendimit të Bordit të ERE për heqjen e licenses, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s rishikimin e tij, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit , në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë **Bordin** në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

I licensuari mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.

## **Neni 12** **Kushte të përkohshme për subjektet e licencuara në sektorin e energjisë elektrike**

1. Në rastet kur ERE merr vendim për heqjen e një licence të licencuarit që ushtron veprimtarinë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes apo furnizimit, ndaj të cilit është vendosur detyrimi i shërbimit publik, në mënyrë që asetet, pronë e të licencuarit, të vazhdojnë të shfrytëzohen për sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike ndaj konsumatorëve, ERE, bazuar në këtë rregullore, vendos një nga masat e përkohshme, të përcaktuara më poshtë:
  - a) merr vendim për të vendosur nën administrim të kufizuar, për një periudhë të caktuar kohore, shoqërinë së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i aktivitetit dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave sipas kësaj rregulloreje.
  - b) cakton një shoqëri tjetër për kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, e cila duhet të përmbushë kushtet përkatëse të licencimit;

- c) merr vendim për të vendosur një administrator të përkohshëm të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i aktivitetit dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave, sipas pikës 3 të këtij neni. Në këtë rast, ERE, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, dhe në përputhje me procedurën dhe kriteret për emërimin e administratorit, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e përkohshëm të shoqërisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave emëron një administrator, i cili është përgjegjës për të siguruar një aktivitet normal, përfshirë edhe operimin e aseteve të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca sipas kushteve përkatëse.
2. Për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ERE përcakton kushtet dhe detyrimet që duhet të zbatohen nga shoqëria së cilës i është hequr licenca, gjatë periudhës së zbatimit të masave të përkohshme. Kompanisë ndaj të cilit ERE aplikon një nga masat përkohëshe të parashikuara në pikën 1, në Vendimin e ERE i jepet leje e ushtrimit të aktivitetit të përkohshëm sipas kushteve që përcakton ERE.
3. Derisa licenca të transferohet te një shoqërie tjetër, do të aplikohen masat e përkohshme, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e heqjes së licencës, zbatimi i të cilave monitorohet nga ERE.

### **Neni 13**

#### **Kushte të përkohshme për subjektet e licencuara në sektorin e gazit natyror**

1. Në rastet kur ERE merr vendim për heqjen e një licence të licencuarit që ushtron veprimtarinë e transmetimit, shpërndarjes, operimit të GNL-së ose të operimit të sistemit të depozitimit, ndaj të cilit është vendosur detyrimi i shërbimit publik, në mënyrë që asetet, pronë e të licencuarit, të vazhdojnë të shfrytëzohen për sigurinë e furnizimit të gazit natyror ndaj klientëve, ERE, bazuar në këtë rregullore, vendos një nga masat e përkohshme, të përcaktuara më poshtë:
- a) merr vendim për të vendosur nën administrim të kufizuar, për një periudhë të caktuar kohore, shoqërinë së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohen ushtrimi i veprimtarisë dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave, sipas ligjit;
- b) cakton një shoqëri tjetër për kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, e cila duhet të përmbushë kushtet përkatëse të licencimit;
- c) merr vendim, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, dhe në përputhje me procedurën dhe kriteret për emërimin e administratorit, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e përkohshëm të shoqërisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, për të emëruar një administrator të përkohshëm të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i veprimtarisë së operimit të aseteve të saj deri në marrjen e masave, sipas pikës 3 të këtij neni.

2. Për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ERE përcakton kushtet dhe detyrimet që duhet të zbatohen nga shoqëria, së cilës i është hequr licenca, gjatë periudhës së zbatimit të masave të përkohshme.

3. Derisa licenca të transferohet te një shoqëri tjetër ose t'i rijepet së njëjtës shoqëri, do të aplikohen masat e përkohshme, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e heqjes së licencës, zbatimi i të cilave monitorohet nga ERE.

**PJESA E TRETË**  
**DISPOZITA TE FUNDIT**  
**Neni 15**  
**Amendime të Rregullores**

Këto Rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s, në përputhje me “Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të ERE” miratuar me Vendimin e ERE nr 96 datë 17.06.2016

**Neni 16**  
**Hyrja në Fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.